



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor  
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 2/662  
Datë: 25/9/2019

Në bazë të nenit 28 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, për shkak të dështimit të zbatimit të kushteve të marrëveshjes nr. 1/662, dt.11.6.2019, e marr këtë

**V E N D I M**

1. Shkëputet Marrëveshja e Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit në mes të "Smart Center" dhe Universitetit të Prishtinës nr. 1/662, dt.11.6.2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Arsyetim**

Arsyet e shkëputjes së Marrëveshjes së Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit në mes të "Smart Center" dhe Universitetit të Prishtinës nr. 1/662, dt.11.6.2019, qëndrojnë në faktin se institucioni "Smart Center" ka dështuar në implementim të Udhëzimit Administrativ (QRK), nr. 03/2018, për gjuhët e huaja në programin e ciklit të dytë apo të tretë, respektivisht të marrëveshjes në fjalë, për të ofruar certifikatë për gjuhë të huaja sipas këtij udhëzimi. Prandaj, duke pasur parasysh se marrëveshja e sipërshënuar parasheh mënyrën e rivlerësimit të saj nga palët, në rast të mospërmbushjes nga palët nënshkruese, mbi këtë bazë, rektori i UP-së, si autoritet nënshkrues i marrëveshjes për Universitetin e Prishtinës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Institucionit "Smart Center";
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
4. Zyrës për shërbimin e studentëve në AQ.



Prof. dr. Marjan Dema

*[Signature]*  
Rektor i UP-së